

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Thatësira dhe kostot e larta godasin misrin, fermerët e Gjergjanit në Elbasan: Nuk na del as qiraja - Euro news Albania
ADRESA	https://euronews.al/thatesira-dhe-kostot-e-larta-godasin-misrin-fermeret-e-gjergjanit-ne-elbasan-nuk-na-del-as-qiraja/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:03:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 14:59:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	258f17baa54129d7608374b50b5dbeba816717e3ddb360f8f97ed538ba9db7bb
TEKSTI	ffde0c5834661a821bbb5fb749a5bdd6f360fc27aec3f1677da98a79054f127c
PAMJA	6ed84458130c01204406ac34d140721824189c910b51ed1c5c914a3ba931d307

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	22fe1d7c68aef9094c4fe176ff889c2769341789ae379430d1dee1160c030de0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/22fe1d7c68aef9094c4fe176ff889c2769341789ae379430d1dee1160c030de0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Lufta në Iran SHBA Kuvendi i Kosovës Edi Rama Rusia

LAJMI I FUNDIT | SOCIALE

Thatësira dhe kostot e larta godasin misrin, fermerët e Gjergjanit në Elbasan: Nuk na del as qiraja

28 Shtator 2026 | 16:59

Thatësira, temperaturat e larta dhe mungesa e ujit për vaditje kanë dëmtuar prodhimin e misrit në zonën e Gjergjanit në Elbasan. Fermerët thonë se këtë sezon kanë marrë shumë më pak prodhim nga tokat e tyre, ndërsa kostot e plehrave, punës dhe kultivimit kanë vijuar të rriten.

Për një fermer, dy dynymë tokë kanë dhënë vetëm 2 kuintalë misër, shumë larg rendimentit që ai pret nga kjo sipërfaqe.

“Prodhimi i misrit ka qenë shumë i dobët dhe i grurit ka qenë shumë i dobët. Plehrat janë në qiell. Vaditja sivjet ka pasur mungesë uji fare për vaditje. Na u shemb kanali dhe me zor kemi vaditur. Dhe ja ku është prodhimi, 2 kuintalë misër. Po di gjë? A na del vërtet neve ky 2 kuintalë misër në 2 dynym? Ai duhet të japë mbi 10 kuintalë. Plehrat kanë vajtur një mijë lekë, ureja 100. Ta shohin televizorët, edhe i ngrenë plehrat... Edhe ne s’kemi çfarë bëjmë. Shpenzimet fillojnë që nga prashitja, mbathja, vaditja... Ja misri im, bereqeti im! Ky është bereqeti im në 2 dynym”, thotë fermeri Ramiz Luga..

Mungesa e ujit dhe temperaturat e larta janë reflektuar drejtpërdrejt në prodhim. Fermerët thonë se misri kërkon vaditje pikërisht në periudhën kur temperaturat janë më të larta, ndërsa dëmtimi i kanalit u ka vështirësuar furnizimin me ujë.

“Shumë! Shumë! Një muaj e ca u shemb kanali atje dhe ne ngelëm pa vaditur misrin. E misri do ujë kur e do ai, jo kur ta rregullojë shteti atë kanal. Me zor e rregulluan, mbas një muaji e gjysmë. Po misri duhej të ishte vaditur. U tha, ra nga thatësira misri”, thotë fermeri Ramiz Luga.

Por krahas prodhimit të dobët, fermerët përballen edhe me kostot e larta të kultivimit. Plehrat, punimet dhe shpenzimet e tjera, sipas tyre, kanë bërë që të ardhurat nga prodhimi të mos mjaftojnë për të mbuluar investimin.

“Po do heqim dorë, po çfarë të mbjellim në tokë? Unë nuk i dal me tokën. Unë këtë e kam marrë me qira dhe nuk del as qiraja. Shes misrin edhe del qiraja. I merr nga jashtë të gjitha, ja, po detyrohesh të vijnë nga jashtë, sepse ne s’kemi mundësi. Unë nuk kam nxjerrë lekët e plehut me këtë misër. Të falimentuar. Po çfarë bëjmë ne?! Plus, s’ka punëtorë këtu, kanë ikur të gjithë jashtë. Nuk ka fuqi punëtores. Pastaj, sa do më paguajë mua ai që të shkoj të punoj unë atje? Këtu punojnë vetëm traktorët”, thotë fermeri Ramiz Luga..

LAJMI I FUNDIT

16:46 Nga bateri të përdorura të makinave elektrike në depo energjie, mundësia e re që po shqyrton Europa

16:42 Avioni bën ulje emergjente në Portugali, pas një problemi në bord

16:41 Pogradec, zjarr masiv në një kodër pranë Mëmlishtit, rrezikohet masivi pyjor me pisha

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

16:34 Sulm ajror në Myanmar, të paktën 33 persona humbën jetën në bombardime

16:25 Gjermania mbështet Gjykatën Ndërkombëtare Penale pas sanksioneve nga Amerika

16:02 Rasti i parë në Holandë, 2-vjeçarja i nënshtrohet eutanazisë

TESTIM

Me prodhimin në rënie dhe kostot në rritje, fermerët thonë se bujqësia po bëhet gjithnjë e më e vështirë për t'u mbajtur. Për ta, një sezon i dobët nuk nënkupton vetëm më pak të ardhura, por edhe pikëpyetje mbi sipërfaqet që do të mbjellin në sezonin e ardhshëm.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

EVROPA | LAJMI I FUNDIT

Nga bateri të përdorura të makinave elektrike në depo energjie, mundësia e re që po shqyrton Europa

Bateritë e vjetra të makinave elektrike mund të marrin një jetë të dytë, duke u përdorur për ruajtjen e energjisë së prodhuar nga dielli dhe...

16:46 | 28/09/2026

BOTA | EVROPA | LAJMI I FUNDIT

Një telefonatë në 999 zbuloi gjithçka, si u kapën 5 britanikët pranë bazës së RAF-it

Pesë shtetas britanikë nga Londra, të moshës 23 deri në 25 vjeç, janë personat e arrestuar pranë bazës ajrore RAF Fairford në Gloucestershire, në kuadër...

15:52 | 28/09/2026

EKONOMI | LAJMI I FUNDIT | VENDI

Ekosistemi shqiptar i inovacionit prezantohet në Bits & Pretzels: 17 startupe, nga Shqipëria, Kosova dhe diaspora

Ekosistemi shqiptar i inovacionit, që po konsolidohet si një rrjet sipërmarrjesh, me ambicie ndërkombëtare, po prezantohet në Bits & Pretzels 2026, një nga eventet më...

15:30 | 28/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontaktoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: